

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**RREGULLORE
E PUNËS SË KUVENDIT TË KOSOVËS**

**Prishtinë, 20 maj 2005
e ndryshuar dhe plotësuar me 1 qershor 2006**

Kuvendi i Kosovës,

Në pajtim me kreun 9.1.26, f) të Kornizës Kushtetuese dhe të Rregullës 4.4 të Rregullores së punës të Kuvendit.

Me qëllim të përcaktimit të rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Kuvendit, duke përfshirë këtu: Kryesinë, komisionet, grupet parlamentare, administratën, si dhe çështje të tjera të procedurave në Kuvend,

Miraton:

RREGULLOREN E PUNËS SË KUVENDIT TË KOSOVËS

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Rregulla 1: Dispozita të përgjithshme

Kjo rregullore pune i përcakton organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Kosovës, të kryetarit dhe të Kryesisë së Kuvendit, të komisioneve parlamentare dhe të trupave të tjerë të Kuvendit.

Rregulla 2: Përkufizimet

Nocionet e përdorura në këtë rregullore të punës kanë kuptimin, si vijon:

Amendament : propozim për ta ndryshuar, për ta fshirë ose për të shtuar diçka përmbajtjesore në dispozitat e Kornizës Kushtetuese dhe të të gjitha akteve të tjera të miratuara nga Kuvendi.

Deklaratë : deklaram i përgjithshëm politik, që votohet dhe miratohet nga Kuvendi;

Projektligj : propozim ligji që nëpërmjet Zyrës për Propozime dhe për Parashtrësia dërgohet në seancë plenare për debat dhe për votim.

Ligj : akt juridik që miratohet nga Kuvendi i Kosovës, me të cilin rregullohet një fushë e caktuar.

Komisioni përgjegjës raportues : komision parlamentar që angazhohet për një ligj ose për një akt nënligjor dhe që sipas rregullave të procedurës ka rolin drejtues në lidhje me raportimin për këtë pjesë të legjislacionit në Kuvend. Nëse një çështje i përket fushës së më shumë se një komisioni funksional, Kuvendi me anë të një propozimi të Kryesisë, mund të caktojë cili komision është komision drejtues.

Mocion :

- (a) një propozim përmbajtjesor të shkruar e të dorëzuar në Zyrën për Propozime dhe Parashtrësia; ose

- (b) një propozim procedural, të shkruar që i prezantohet Kuvendit, për shqyrtim dhe votim në pajtim me këtë rregullore.

Mocion përmbajtjesor : propozim për

- a) një rezolutë;
- b) një amendament ose
- (c) akt tjetër që miratohet nga Kuvendi.

Dokument zyrtar i Kuvendit : çdo pyetje, mocion ose projektligj që u shpërndahet deputetëve të Kuvendit, përgjigjet me shkrim për pyetjet, rekomandimet e bëra ose raportet e përgatitura nga komisionet, procesverbali, si dhe çdo material i dorëzuar për shqyrtim nga Kuvendi ose ndonjëri nga komisionet e tij. Këtu nuk përfshihen regjistrimet e punës së Kuvendit.

Grupi parlamentar : grupimet e jo më pak se 5 %, përkatësisht 6 deputetë të Kuvendit, që e kanë njoftuar kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit për qëllimin e tyre të veprojnë si grup parlamentar.

Raportues : anëtar i një komisioni i caktuar nga komisioni për të raportuar për projektligjin në mbledhjet e Kuvendit ose në komision. Komisioni mund të caktojë raportues të ndryshëm për të raportuar për çështje të ndryshme.

Rezolutë : një mocion i shkruar me të cilin Kuvendi me votimin shpreh vullnetin e vet për një çështje të caktuar.

Shqyrtimet : fazat nëpër të cilat kalon një ligj në përputhje me këtë rregullore.

Seanca plenare : mbledhje e Kuvendit që mbahet brenda një kohe të caktuar.

Propozues : grupi parlamentar, anëtari raportues të një komisioni, deputeti i Kuvendit, Kryeministri ose ministri që ka përgatitur një mocion përmbajtjesor, një projektligj ose një akt tjetër për diskutim.

Zyra për propozime dhe parashtrësia : zyrë, në kuadër të administratës së Kuvendit, në të cilën deputetët, propozuesit dhe parashtruesit e tjerë të autorizuar i dorëzojnë pyetjet, mocionet, projektligjet etj., që pastaj u shpërndahen deputetëve të Kuvendit ose dorëzohen në Kuvend.

Çështje urgjente : një çështje e ngutshme e paraqitur ndërkohë dhe që si e tillë nuk mund të parashtrohej në Kuvend, në mënyrë të rregullt, për të cilën vendos Kuvendi.

Ditë pune : një ditë e javës, nga e hëna deri të premten, duke përfshirë këto të dyja, me përjashtim të festave zyrtare (publike), gjatë javës në të cilën Kuvendi do të mblidhej normalisht.

KREU II KONSTITUIMI I KUVENDIT

Rregulla 3: Seanca konstituive

1. Seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës thirret brenda tridhjetë (30) ditësh pas vërtetimit të rezultatit të zgjedhjeve.

2. Seancën konstituive e thërret kryetari i Kuvendit nga përbërja e mëparshme, ndërsa fillimisht e kryeson deputeti më i vjetër në moshë i Kuvendit, i ndihmuar nga deputeti më i ri derisa të zgjidhet kryetari i Kuvendit.
3. Kryesuesi kërkon nga partitë parlamentare ta caktojnë nga një deputet në Komisionin për Mandate dhe Imunitete.
Pas verifikimit të mandateve, deputetët betohen solemnisht. Teksti i betimit është si vijon:

“Unë, deputet i Kuvendit të Kosovës, i zgjedhur me votën e lirë, sot solemnisht betohem se me ndershmëri e me sinqeritet, me përkushtim dhe devotshmëri, me tërë qenien time, me të gjitha aftësitë e mia do të punoj në interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve, do të angazhohem në mbrojtjen e respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, në mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, në garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në pajtim me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane.”

Betohem

Tekstin e lexon kryesuesi, kurse deputetët betohen duke e shqiptuar fjalën “Betohem”. Secili deputet nënshkruan tekstin e betimit.

4. Kuvendi në seancën konstituive ose në mbledhjen tjetër të radhës, do ta formojë një komision *ad hoc* për Rregulloren e punës të Kuvendit. Komisioni krijohet dhe vepron sipas procedurave të parashtuara në rregullën 41 e në vijim. Komisioni përgatit projektin e rregullores së punës dhe ia paraqet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Rregullorja e punës duhet të jetë në pajtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme.

Rregulla 4: Zgjedhja e Kryesisë

1. Kryesia e Kuvendit përbëhet prej 8 anëtarëve.
2. Kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga përfaqësuesit e partive ose të koalicioneve që kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të Kryesisë së Kuvendit, t’i paraqesin emrat e anëtarëve të propozuar, si vijon:
 - a) Dy anëtarë nga partia ose koalicioni që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet për Kuvend;
 - b) Dy anëtarë nga partia e dytë ose nga koalicioni i dytë me numrin më të madh të votave;
 - c) Një anëtar nga partia e tretë ose nga koalicioni i tretë me numrin më të madh të votave;
 - d) Një anëtar nga partia e katërt ose nga koalicioni i katërt me numrin më të madh të votave;
 - e) Një anëtar nga ata të partive që janë deklaruar se janë përfaqësues të komunitetit serb të Kosovës dhe
 - f) Një anëtar nga ata të partive që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitete të tjera, përpos komunitetit shqiptar dhe komunitetit serb të Kosovës.
3. Kryesuesi kërkon nga përfaqësuesi i etnitetit politik, që ka marrë numrin më të madh të votave, të deklarojë se cili nga dy të emëruarit për Kryesi propozohet për kryetar të Kuvendit.

4. Kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga Kuvendi që me votim t'i zgjedhë Kryesinë dhe kryetarin e Kuvendit. Pas kësaj, kryetari e merr detyrën.

KREU III KRYESIA

Rregulla 5: Mandati i Kryesisë

1. Mandati i funksionit të kryetarit të Kuvendit dhe i anëtarëve të Kryesisë do të jetë në përputhje me mandatin e përbërjes së Kuvendit.
2. Kuvendi pezullon punën nga dita e fillimit të fushatës zgjedhore. Gjatë kësaj kohe Kryesia e Kuvendit e vazhdon punën me qëllim që të ruhet kontinuiteti i Kuvendit të Kosovës.
3. Kryetari i Kuvendit mund t'i paraqesë dorëheqjen Kuvendit. Aktin e dorëheqjes me shkrim ia dorëzon paraprakisht Kryesisë së Kuvendit. Pas miratimit të dorëheqjes, partia politike ose koalicioni që e ka emëruar ish- kryetarin e Kuvendit, propozon kandidatin për kryetar, në pajtim me rregullën 4 të kësaj rregulloreje.
4. E njëjta procedurë zbatohet edhe në rast të dorëheqjes së ndonjë anëtari të Kryesisë.
5. Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit ose i anëtarit i Kryesisë së Kuvendit, në propozim të partisë politike apo grupit që e ka emëruar, bëhet sipas procedurës së zgjedhjes së tyre.

Rregulla 6: Detyrat e Kryesisë

1. Kryesia, në fillim të mandatit zgjedhor, bën marrëveshje të grupeve parlamentare për numrin e komisioneve, për emërimin e kryetarëve dhe të zëvendëskryetarëve të komisioneve, për të cilët vendos Kuvendi.
2. Kryesia është përgjegjëse për programin e punës të Kuvendit. Ajo rishikon dhe përgatit rendin e ditës të mbledhjes së radhës të Kuvendit dhe merr pëlqimin nga grupet parlamentare për formën dhe për kohëzgjatjen e diskutimit për një çështje të caktuar të punës.
3. Kryesia takohet, të paktën një javë para seancës së ardhshme të Kuvendit, për ta shqyrtuar dhe përgatitur rendin e ditës të mbledhjes së radhës të Kuvendit. Ftesa me rend dite dhe materialet për shqyrtim u dërgohen deputetëve së paku tri ditë pune para seancës plenare.
4. Kryesia angazhohet të sigurojë që një proporcion i arsyeshëm i kohës në seancat plenare të Kuvendit t'u lihet në dispozicion çështjeve të paraqitura nga grupet parlamentare që nuk janë të përfaqësuara në Qeveri. Koha që do të vihet në dispozicion në këtë mënyrë: do të jetë jo më pak se një orë për një mbledhje. Nëse nuk arrihet marrëveshje për këto çështje, Kuvendi do të vendosë në seancë plenare në fillim të takimit.
5. Kryesia siguron që çfarëdo mocioni përmbajtjesor që mbështetet nga gjashtë ose më shumë deputetë të Kuvendit, të futet në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes, për të cilën çështje vendos Kuvendi.

6. Kryesia e Kuvendit emëron sekretarin e Kuvendit dhe ai i përgjigjet drejtpërsëdrejti Kryesisë. Sekretari i Kuvendit kryen detyrat në bashkërendim të ngushtë me kryetarin e Kuvendit.
7. Kryesia miraton projektbuxhetin e Kuvendit, të përgatitur nga Komisioni për Buxhet në bashkëpunim me administratën e Kuvendit.
8. Kryesia vendos për mjetet financiare dhe për rregullat, të cilave u nënshtrohen deputetët, stafi i grupeve parlamentare, për akomodimin dhe për pajisjen e tyre. Kryesia, gjithashtu, vendos lidhur me të drejtat dhe detyrat e personelit të këtij stafi sa u përket dokumentacionit dhe shërbimeve të Kuvendit.
9. Kryesia zhvillon marrëdhënie të jashtme parlamentare dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare të fushës së përgjegjësive të saj, në pajtim me nenin 9.1.28 (b) të Kornizës Kushtetuese.
10. Kryesia kryen edhe detyra të tjera në pajtim me Rregulloren e punës.

Rregulla 7: Mbledhjet e Kryesisë

1. Kryetari i Kuvendit i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kryesisë.
2. Kryetari i Kuvendit e thërret mbledhjen e Kryesisë nëse kërkohet nga një grup parlamentar, ose nga pesë për qind, përkatësisht 6 deputetë të Kuvendit.
3. Vendimet e Kryesisë merren me konsensus. Në mungesë të konsensusit, përveç rasteve të parashikuara në paragrafin paraprak dhe në rregullën 40, do të vendoset me shumicë votash të atyre të pranishëm dhe që votojnë- nëse të paktën pesë anëtarë janë të pranishëm. Në rast votash të barabarta, vendos vota e kryetarit.
4. Në mbledhje të Kryesisë mund të marrë pjesë edhe përfaqësuesi i kryetarit të Kosovës dhe i Qeverisë, por pa të drejtë vote. Sekretari merr pjesë në mbledhje të Kryesisë, sipas detyrës zyrtare.
5. Sipas nevojës, Kryesia e Kuvendit, për çështje të caktuara, i fton edhe shefat e grupeve parlamentare.

Rregulla 8: Përgjegjësitë e kryetarit të Kuvendit

1. Kryetari i Kuvendit e përfaqëson Kuvendin, i thërret dhe i kryeson mbledhjet e Kuvendit, mbikëqyr rendin dhe ushtron edhe detyra që specifikohen në këtë rregullore të punës. Interpretimi i Rregullores së punës nga ana e tij, në mbledhje të Kuvendit është përfundimtar.
2. Kryetari i Kuvendit të Kosovës ushtron funksionin e kryetarit të Kosovës nëse kryetari i Kosovës përkohësisht nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e veta.

Rregulla 9: Të ushtruarit e detyrës së kryetarit të Kuvendit

1. Kryetarin e Kuvendit, në rast mungese, me kërkesë të tij, në ushtrimin e detyrës, mund ta zëvendësojë, njëri nga anëtarët e Kryesisë.

2. Në rastet kur kryetari mungon ose kur kërkon që një anëtar i Kryesisë të veprojë si zëvendës i tij, kryetari i Kuvendit e cakton me autorizim të veçantë cili anëtar i Kryesisë do ta ushtrojë funksionin e tij.
3. Në pamundësi për ta ushtruar detyrën e kryetarit të Kuvendit, atë e zëvendëson anëtari i Kryesisë së Kuvendit nga e njëjta parti.

Rregulla 10: Kryesimi

Në udhëheqjen e punës së seancave të Kuvendit, kryetari i ndihmon njëri nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, sipas radhës së caktuar nga Kryesia.

KREU IV GRUPET PARLAMENTARE

Rregulla 11: Statusi dhe financimi i grupeve parlamentare

1. Grupi parlamentar është grupim politik i përbërë nga jo më pak se 5 për qind, përkatësisht 6 deputetë të Kuvendit në funksion të një qëllimi politik të përbashkët.
2. Formimi i grupit parlamentar dhe emërtimi i tij, duhet të jenë në përputhje me Kornizën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit.
3. Emri i kryetarit dhe i anëtarëve të grupit parlamentar i komunikohen me shkrim kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit.
4. Një deputet nuk mund t'i përkasë më tepër se një grupi parlamentar.
5. Grupit parlamentar i ndihmon një staf administrativ, që për punën e vet shpërblehet në pajtim me udhëzimet e Kryesisë të nxjerra sipas rregullës 6.8.
6. Me vendim të Kryesisë, grupeve parlamentare u jepen fonde vjetore përpjesëtimisht me numrin e vendeve që i kanë në Kuvend.

KREU V DEPUTETËT E KUVENDIT

Rregulla 12: Të drejtat dhe detyrat e deputetëve të Kuvendit

1. Deputetët e Kuvendit kanë të drejtë dhe detyrë të barabartë për pjesëmarrje të plotë në punimet e Kuvendit, duke vepruar sipas bindjeve dhe me vetëdijen e tyre autonome. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm me të drejtën për inicim projektligjesh sipas rregullës 33 dhe rezoluta, për t'u parashtruar pyetje anëtarëve të Qeverisë gjatë kohës në dispozicion. Për këtë qëllim, lidhur me politikën dhe me veprimet e Qeverisë, për të votuar për të gjitha vendimet e propozuara të Kuvendit, por edhe për të marrë pjesë në kushte të barabarta me deputetët e tjerë të Kuvendit në të gjitha diskutimet.
2. Deputeti pajiset me një dokument identifikimi që përmban tekstin, por shërben edhe për imunitetin e tij.

3. Deputeti gëzon të drejta shtesë që duhet të përcaktohen me akt të veçantë të miratuar nga Kuvendi.

Rregulla 13: Imuniteti i deputetëve të Kuvendit

1. Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet të plotë që i mbron nga të gjitha procedurat civile ose penale në lidhje me deklaratimet gojore ose të shkruara ose nga veprimet e tjera të kryera në cilësinë e tyre si deputetë të Kuvendit. Ky imunitet nuk mbulon veprime që haptazi inkurajojnë dhunën ndërmjet komuniteteve.
2. Deputeti gëzon imunitet edhe ndaj çdo mase arresti dhe ndjekjeje penale në lidhje me veprimet e tij, derisa Kuvendi i Kosovës të marrë vendim për heqjen e imunitetit të tij.
3. Kërkesën për heqjen e imunitetit të deputetit e ushtron organi kompetent për ndjekje penale, ndërsa vendimin për heqjen e imunitetit të deputetit e merr Kuvendi, në pajtim me rekomandimet e Komisionit për Mandate dhe Imunitet.
4. Deputeti të cilit i është hequr imuniteti ka të drejtë ankimi personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështje të Kornizës Kushtetuese, që vendos për çështjen.
5. Përjashtimisht nga paragrafi 2 masa e paraburgimit mund të ndërmerret ndaj deputetit pa pëlqimin paraprak të Kuvendit, në rastin kur ai ose ajo kapet në kryerje e sipër (*in flagranti*) të një vepre të rëndë penale, që është e dënueshme me pesë (5) ose më shumë vjet burgim.

Rregulla 14: Humbja e statusit të deputetit të Kuvendit

Deputeti i Kuvendit humb statusin:

1. Nëse dënohet për një vepër penale në Kosovë, me dënim, me burgim për një periudhë prej gjashtë (6) e më shumë muaj.
2. Nëse është akuzuar nga Tribunali Ndërkombëtar i Hagës për Krime Luftë në ish-Jugosllavi por nuk e ka zbatuar urdhrin për tu paraqitur para saj.
3. Nëse deputeti i Kuvendit në periudhën gjashtëmujore (6) nuk merr pjesë në asnjë seancë të Kuvendit ose të Komisionit ku është anëtar dhe nuk mund të dëshmojë arsye bindëse për kryetarin e Kuvendit, atëherë kryetari i Kuvendit i propozon Kuvendit për deputetin në fjalë pushimin e funksionit të tij. Kuvendi do të vendosë lidhur me këtë çështje në seancën e radhës. Për këtë çështje kërkohet mendimi i Komisionit për Mandate dhe Imunitet.
4. Në raste të tilla, deputeti mund t'ia paraqesë Kuvendit me shkrim argumentet për t'i treguar arsyet bindëse për mospjesëmarrje në mbledhje, si dhe do t'i lejohet, gjithashtu, t'i drejtohet shkurtimisht Kuvendit, nëse dëshiron ta bëjë këtë.

5. Deputeti i Kuvendit mund të heqë dorë nga statusi i tij si deputet i Kuvendit dhe për këtë e informon kryetarin e Kuvendit me shkrim për dëshirën e tij për këtë veprim. Kryetari i Kuvendit njofton Kuvendin dhe PSSP-në lidhur me kërkesën e deputetit për dorëheqje.

Rregulla 15: Kodi i mirësjelljes së deputetëve të Kuvendit

1. Deputetët e Kuvendit duhet ta respektojnë kodin e mirësjelljes të dhënë në shtojcën e kësaj rregulloreje të punës që është pjesë përbërëse e saj.

KREU VI KRYETARI I KOSOVËS

Rregulla 16: Zgjedhja e kryetarit të Kosovës

1. Pas mbledhjes konstituive të Kuvendit dhe pas zgjedhjes së kryetarit dhe të Kryesisë së Kuvendit, menjëherë ose jo më shumë se 15 ditë, ose kurdo që vendi mbetet vakant, Kuvendi procedon për zgjedhjen e kryetarit të Kosovës.
2. Nominimi i kryetarit të Kosovës kërkon mbështetjen e partisë që ka siguruar numrin më të madh të vendeve në Kuvend, ose përkrahjen e së paku njëzetepesë (25) deputetëve.
3. Zgjedhja e kryetarit të Kosovës bëhet me votim të fshehtë. Kandidati që merr dy të tretat ose më shumë vota të deputetëve të Kuvendit, shpallet i zgjedhur.
4. Nëse në votimin e parë asnjë kandidat nuk ka sukses, mbahet votimi i dytë, por që serish kërkohet shumica e dy të tretave të votave të deputetëve.
5. Nëse edhe në votimin e dytë asnjë kandidat nuk ka sukses, në votimin e fshehtë vijues zgjidhet kryetar kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Rregulla 17: Shkarkimi nga funksioni i kryetarit të Kosovës

1. Nëse mocioni i shkarkimit nga funksioni i kryetarit të Kosovës mbështetet më së paku nga pesëdhjetë deputetë, Kuvendi pas debatimit do të votojë për mocionin.
2. Në rastet kur mocioni paraqitet në pajtim me paragrafin 1, Kuvendi do të debatojë dhe do të votojë për mocionin brenda pesë ditë pune pas paraqitjes së tij
3. Mocioni duhet ta ketë mbështetjen e dy të tretave të deputetëve të Kuvendit për të pasur sukses.

KREU VII KRYEMINISTRI DHE QEVERIA

Rregulla 18: Zgjedhja e kryeministrit dhe e Qeverisë

1. Kryetari i Kosovës brenda 15 ditësh pas zgjedhjes, ia propozon Kuvendit kandidatin për kryeministër të Kosovës, sikurse dhe në rastet e dorëheqjes së kryeministrit ose nëse funksioni i tij mbetet vakant për çfarëdo arsyeje.

2. Kandidati i propozuar për kryeministër brenda 15 ditësh pas nominimit të tij, duhet t'ia paraqesë Kuvendit programin qeveritar dhe listën e zëvendës kryeministrit, të ministrave dhe të zëvendësministrave të propozuar.
3. Qeveria e Kosovës, e përbërë nga kandidatët për kryeministër, zëvendëskryeministër dhe nga kandidatët për ministra dhe për zëvendësministra, konsiderohet e zgjedhur nëse kandidatët marrin shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit. Mënyrën e votimit për zgjedhjen e Qeverisë e përcakton Kuvendi.
4. Nëse Qeveria, sipas propozimit të dhënë, nuk zgjidhet, kryetari i Kosovës brenda dhjetë ditësh propozon një kandidat të ri për postin e kryeministrit. Në vazhdim përfillet e njëjta procedurë e përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 të kësaj rregulle.

Rregulla 19: Mocioni i mosbesimit për kryeministrin

1. Kuvendi i Kosovës mund t'i shprehë mosbesimin kryeministrit në bazë të mocionit të parashtruar së paku nga një e katërta, përkatësisht 30 deputetë të Kuvendit dhe vetëm nëse në të njëjtën kohë zgjidhet kryeministri i ri së bashku me ministrat e rinj me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit.
2. Mocioni duhet të nënshkruhet së paku nga një e katërta, përkatësisht nga 30 deputetë të Kuvendit. Mocioni i mosbesimit duhet të përmbajë edhe një propozim me emrin e pasardhësit të kryeministrit. Kryetari i Kosovës duhet ta respektojë këtë propozim.
3. Kuvendi vendos për mocionin e mosbesimit, brenda pesë ditësh.
4. Mandati i kryeministrit përfundon vetëm me zgjedhjen e kryeministrit të ri.

Rregulla 20 : Mocioni i kryeministrit për votëbesim

1. Kryeministri mund të iniciojë një mocion votëbesimi. Ky mocion mund të kombinohet me votimin për një projektligj.
2. Mocioni votohet pasi të kenë kaluar dyzet e tetë orë nga parashtrimi i tij.
3. Mocioni duhet të mbështetet nga shumica e deputetëve të Kuvendit.
4. Nëse Kuvendi nuk arrin ta zgjedhë kryeministrin brenda njëzet e një ditësh, Kuvendi mund t'i propozojë PSSP-së shpërndarjen e Kuvendit.

KREU VIII

MIRATIMI I LISTËS SË GJYQTARËVE DHE TË PROKURORËVE TË REKOMANDUAR

Rregulla 21: Miratimi i listës për emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të rekomanduar

1. Kuvendi i Kosovës në bazë të rekomandimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës (KGJP), brenda 30 ditësh shqyrton dhe miraton listën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe ia dorëzon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm

- për emërim, duke i pasur parasysh kriteret e parapara për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.
2. Kuvendi mund të kërkojë sqarime shtesë nga KGJP-ja në lidhje me kandidatët e rekomanduar për emërim si gjyqtarë dhe prokurorë. Në këto raste kur merret vendimi nga Kuvendi mund të shtyhet për dhjetë (10) ditë nga dita e marrjes së informatës shtesë.
 3. Nëse nuk merret kurrfarë veprimi nga ana e Kuvendit për t'ia dërguar rekomandimin e KGJP-së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm brenda kohës së paraparë në paragrafin 1 të kësaj rregulle, atëherë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të marrë masa, duke u bazuar në emërimet e rekomanduara nga KPGJ-ja.
 4. Kërkesat për shkarkimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Kosovë i dërgohen Kuvendit për informim nga KGJP-ja, në të njëjtën kohë që këto kërkesa i dorëzohen PSSP-së.
 5. Për këto kërkesa njoftohet Kuvendi në seancën plenare, së nga KGJPK-ja mund të kërkojë sqarime shtesë në lidhje me këto kërkesa .

KREU IX PUNA NË KUVEND

Rregulla 22: Rendi në mbledhjet e Kuvendit

1. Kuvendi i zhvillon punimet sipas kalendarit të propozuar nga Kryesia në konsultim me Qeverinë, me përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe të komisioneve parlamentare, të miratuara nga Kuvendi.
2. Kuvendi zhvillon punime në seanca plenare dhe në komisione.
3. Kryesia e Kuvendit vendos për datën dhe për rendin e ditës të mbledhjes së Kuvendit.
4. Seancat plenare të Kuvendit mbahen zakonisht dy herë në muaj. Java plenare fillon zakonisht ditën e enjte dhe përfundon të premten. Kryesia mund t'i shmangët këtij rendi kurdo që e konsideron të nevojshme.
5. Shqyrtimi i një projektligji ose mocioni përmbajtjesor bëhet në pajtim me rendin e mëposhtëm:
 - a) Propozuesi i projektligjit ose i mocionit përmbajtjesor flet i pari;
 - b) Në rastet kur propozues nuk është Qeveria, Kuvendi mund të kërkojë deklarimin e Qeverisë;
 - c) Kryetari ose raportuesi i komisionit përgjegjës raportues;
 - d) Kryetarët e komisioneve kryesore;
 - e) Kryetarët e grupeve parlamentare;
 - f) Të gjithë deputetët e tjerë të Kuvendit kanë të drejtë të diskutojnë në lidhje me projektligj ose mocion përmbajtjesor ,sipas rendit të caktuar nga kryetari i Kuvendit.

- g) Në fund të diskutimeve, propozuesi i Projektligjit ose i mocionit përmbajtjesor, ka të drejtë të përgjigjet dhe pastaj kryetari i Kuvendit i mbyll diskutimet.
- 6.
- a. Deputeti ose ministri ka të drejtë t'i përgjigjet diskutimit të një deputeti ose ministri tjetër kur ky deputet ose ministër ta ketë përmendur emrin e deputetit ose të ministrit të parë, ose diskutimin e tij.
 - b. E drejta për t'u përgjigjur sipas pikës (a) kufizohet në dy minuta ,menjëherë pas përfundimit të diskutimit përkatës.
 - c. Nëse një deputet ose ministër ushtron të drejtën për t'u përgjigjur sipas pikës (a), është e lejueshme një replikë deri në një minutë nga ana e folësit fillestar, menjëherë pas përgjigjes.
7. Diskutimi në Kuvend nuk zgjat më shumë se 10 (dhjetë) minuta për secilin deputet të Kuvendit, nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe . Diskutimi lidhur me rendin e ditës nuk zgjat më shumë se dy (2) minuta.
8. Deputetët që dëshirojnë të diskutojnë duhet të paraqiten te kryetari i Kuvendit, që e cakton radhën që ata të thirren sipas radhës së paraqitjes.
9. Nëse kryetari i Kuvendit konstaton se është në të mirë të diskutimit , mund t'i lejojë deputetit të flasë më tepër se koha në dispozicion.
10. Kryetari i Kuvendit kujdeset për rregullin në Kuvend dhe ia tërheq vërejtjen secilit deputet të Kuvendit ose anëtarit të Qeverisë kur:
- a) Diskutuesi largohet nga çështja e parashtruar për diskutim;
 - b) Bën ndonjë veprim kërcënues që prish rregullin e punës së Kuvendit;
 - c) Ka sjellje të pahijshme dhe të palejueshme;
 - d) Ngrit një çështje jashtë temës së debatit ose mocionit;
 - e) Sulmon ose i reziston një punonjësi të policisë, ose punonjësit të Kuvendit që vepron sipas urdhrat të kryetarit të Kuvendit ose
 - f) nuk respekton autoritetin e kryetarit të Kuvendit;
 - g) Përdor gjuhë jo parlamentare, qoftë të shkruar qoftë të folur, në Kuvend ose në komisione, si vijon :
 - i. Është ofenduese, shpifse, apo kërcënuese;
 - ii. Përdoret për sulme ose për fyerje personale;
 - iii. Është gjuhë e pahijshme;
 - iv. Nxit dhunë ndëretnike.
11. Kryetari i Kuvendit mund ta urdhërojë një deputet ose ministër, që sipas mendimit të tij ka përdorur gjuhë jo parlamentare, t'i tërheq fjalët e tilla, ose nëse do të jetë e nevojshme merr masa në pajtim paragrafin 13 të kësaj rregulle.
12. Deputeti ose ministri është i detyruar t'i respektojë urdhrat e kryetarit të Kuvendit për sjelljen për të cilën atij tashmë i është tërhequr vërejtja,pa u kufizuar vetëm në këto masa :
- a) Heqje dorë nga gjuha jo parlamentare;
 - b) Ndërprerja e menjëhershëm e fjalimit;

- c) Largimi nga punimet e Kuvendit, duke përfshirë edhe mbledhjet e komisioneve për tërë ditën.
- d) Në rastet kur kërkohet veprim i mëtejshëm, duke përfshirë edhe kërkesën për ndërhyrjen e një ose më shumë zyrtarëve të policisë, kryetari i Kuvendit konsultohet me Kryesinë para se të urdhërojë një masë të tillë disiplinore. Në këtë rast zyrtarët e policisë veprojnë sipas udhëzimeve të kryetarit të Kuvendit.

13. Në rast të ndonjë parregullsie serioze në Kuvend, kryetari i Kuvendit mund ta shtyjë seancën në tërësi, ose mund të pezullojë për një kohë të caktuar.

14. Kryesia e Kuvendit nxjerr rregulla përkitazi me sjelljen e publikut dhe të përfaqësuesve të shtypit dhe të personave të tjerë, që ndjekin takimet e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit kërkon nga të gjithë personat që nuk i respektojnë rregullat e tilla, të largohen. Zyrtarët e policisë do të veprojnë sipas udhëzimeve të kryetarit të Kuvendit.

Rregulla 23: Rendi i ditës

1. Kryesia përgatitë një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës së Kuvendit dhe menjëherë të njëjtin e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit.
2. Në fillim të seancës ky propozim rend dite do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare, apo gjashtë (6) anëtarë të Kuvendit i propozojnë me shkrim kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hidhet në votim.
3. Nëse cilido deputet, në cilëndo kohë, e sheh të nevojshme të amendamentohet rendi i ditës për të përfshirë në të një çështje urgjente, duhet ta bëjë një propozim të tillë në pajtim me Rregullën 29.
4. Kryesia konsultohet me kryetarët e grupeve parlamentare për caktimin e rendit të ditës të seancave të Kuvendit.
5. Kryesia, po ashtu, konsultohet me grupet parlamentare të paktën një herë në muaj në lidhje me çështjet e përgjithshme të orarit të punës, siç janë: numri i orëve në ditë, numri i ditëve në javë dhe numri i javëve në vit, gjatë të cilave Kuvendi planifikon t'i mbajë mbledhjet.
6. Kryesia thërret, me nismën e vet, ose si përgjigje ndaj kërkesës së bërë nga kryeministri, nga një ose më shumë grupe parlamentare, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën, përkatësisht 40 deputetë në Kuvend, seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, në mënyrë që ta trajtojë një çështje të ngutshme. Kërkesa duhet të përmbajë çështjen ose çështjet që do të shqyrtohen si dhe arsytet pse ato konsiderohen të ngutshme dhe të rëndësishme që edhe në mënyrë të tillë të shqyrtohen në Kuvend. Në raste të tilla shqyrtohen vetëm çështjet që përbëjnë bazën e kërkesës.
7. Në rastet kur projektligji miratohet në shqyrtimin e parë, Kuvendi njëherit e ngarkon komisionin përgjegjës raportues për ta shqyrtuar projektligjin.

Rregulla 24: Publiciteti dhe regjistrimi i seancave plenare

1. Seancat e Kuvendit janë publike, përveç në rastet kur Kuvendi vendos ndryshe. Ato transmetohen, në pajtim me aranzhimet, për të cilat vendos Kryesia e

Kuvendit. Regjistrimet mbahen për çdo seancë plenare të Kuvendit dhe çdo diskutim regjistrohet në gjuhën në të cilën është bërë. Në procesverbal jepet rezymeja e diskutimeve dhe e vendimeve që i merr Kuvendi.

2. Regjistrimet sipas paragrafit 1 publikohen dhe:
 - a) ruhen në dosjet e arkivave të Kuvendit dhe
 - b) i vihen në dispozicion publikut sipas ligjit.

Rregulla 25: Interpelanca

1. Një grup parlamentar mund të parashtojë kërkesë për interpelancë për të shqyrtuar një çështje që ka të bëjë me punën e Qeverisë ose të një Ministrie të caktuar.
2. Rendi i ditës së seancës plenare mund të përmbajë një interpelancë e cila mund të zgjasë maksimalisht dy (2) orë.
3. Në rast se më shumë se një grup parlamentar ka në pritje një kërkesë për interpelancë, Kryesia i jep mundësinë secilit grup parlamentar për të mbajtur interpelancën, sipas radhës së dorëzimit të tyre, në njërën nga seancat e radhës.
4. Mocioni për interpelancë parashtrohet në formë të shkruar dhe përmban:
 - a) Formulimin e saktë të çështjes që është lëndë e interpelancës;
 - b) Arsyetimin për mocionin;
 - c) Emrin dhe nënshkrimin e autorizuar nga grupi parlamentar në fjalë.
5. Interpelanca i paraqitet Kryesisë së Kuvendit. Me marrjen e tekstit të interpelancës, Kryesia ia dërgon atë Qeverisë, e cila është e obliguar ta shqyrtojë brenda shtatë (7) ditëve.
6. Interpelanca vihet në rendin e ditës në afatin prej shtatë (7) ditësh pasi të merret përgjigja nga Qeveria. Në qoftë se Qeveria në afatin e paraparë në paragrafin 5 nuk e dërgon përgjigjen lidhur me interpelancën, interpelanca vihet si pikë e fundit e rendit të ditës të seancës plenare të Kuvendit që është në zhvillim e sipër. Nëse Kuvendi nuk është në seancë, atëherë ajo vihet si pikë e parë në rendin e ditës së seancës së parë të radhës të Kuvendit. Kuvendi nuk mund ta refuzojë vënien e interpelancës në rendin e ditës, përveç në rast se ajo nuk i plotëson kushtet formale sipas paragrafit 4 të kësaj rregulle.
7. Grupi parlamentar që ka propozuar debatin për interpelancë ka të drejtë ta fillojë debatin me një kohë që nuk i kalon dhjetë (10) minuta. I njëjti grup parlamentar ka të drejtë ta mbyll debatin me një kohë që nuk i kalon pesë (5) minuta. Deputetët tjerë kanë të drejtë të debatojnë për çështjen e ngritur në interpelancë në pajtim me Rregulloren e Punës. Koha e ndarë për grupet parlamentare duhet të reflektoj përfaqësimin e tyre në Kuvend.
8. Kryeministri ose ministri të cilit i parashtrohet interpelanca ka për detyrë të paraqesë dhe të arsyetojë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjen e shtruar të interpelancës.

9. Grupi parlamentar i cili ka kërkuar interpelancën mund të kërkoj (në kuadër të kohës së ndarë për të) që të votohet një mocion në fund të debatit për interpelancë, me kusht që mocioni të ketë qenë i përfshirë në kërkesën fillestare për interpelancë.
10. Debat i lidhur me interpelancën nuk mund të vazhdojë në seancën e ardhshme të Kuvendit.
11. Interpelanca për të njëjtën çështje nuk mund të parashtrohet më shumë se dy herë gjatë një viti buxhetor.

Rregulla 26: Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë

1. Rendi i ditës për secilën seancë të Kuvendit do të përfshijë një periudhë për pyetje, e cila do të kufizohet në pesëdhjetë (50) minuta.
2. Çdo anëtar i Kuvendit mund të kërkojë nga një anëtar i Qeverisë që të përgjigjet në pyetje, me kusht që ajo pyetje është dorëzuar me shkrim, në Zyrën për Propozime dhe Parashtrës, së paku dyzetetë (48) orë para mbajtjes së seancës.
3. Formulimi i pyetjes duhet të respektoj kushtet sipas Rregullës 22.10.
4. Deputeti i cili e parashtron pyetjen me shkrim të njëjtën e paraqet edhe me gojë gjatë periudhës së pyetjeve.
5. Pyetja nuk mund të zgjasë më shumë se një (1) minutë.
6. Përgjigja në pyetje nuk mund të jetë më e gjatë se tre (3) minuta.
7. Një pyetje plotësuese me gojë mund t'i paraqitet të njëjtit anëtar Qeverie dhe e njëjta nuk mund të zgjasë më shumë se një (1) minutë.
8. Një përgjigje plotësuese me gojë mund të jepet por nuk mund të zgjasë më shumë se dy (2) minuta.
9. Një deputet i cili e parashtron pyetjen në pajtim me Rregulloren e Punës ka të drejtë ta parashtoj pyetjen edhe nëse qeveria akoma nuk e ka përgatitur përgjigjen.
10. Një pyetje mund t'i drejtohet kryeministrit, por kryeministri atë mund t'ia kalojë një ministri në bazë të vlerësimit të tij.
11. Nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave ajo publikohet në Buletinin e Kuvendit.

Rregulla 27: Pyetjet për përgjigje me shkrim

Deputetët mund t'i parashtrojnë kryeministrit ose ndonjë ministri pyetje për përgjigje me shkrim lidhur me fushën e tij të përgjegjësisë. Përgjigja jepet jo për më shumë se dy (2) javë pas datës së parashtrimit të pyetjes dhe futet në procesverbalin e punimeve të Kuvendit për ditën kur është dhënë përgjigja ose për ditën e parë pas saj, kur Kuvendi mbledhet në seancë plenare. Lista e pyetjeve

për të cilat nuk është dhënë përgjigje brenda kohës së caktuar, publikohet në Buletinin e Kuvendit dhe u shpërndahet deputetëve.

Rregulla 28: Fjalimet e ministrave

Në çdo seancë plenare të Kuvendit, ministri me kërkesë të tij dhe në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit, mund të flasë në Kuvend për ndonjë çështje që ka të bëjë me fushëveprimin e përgjegjësive të tij. Kur është e arsyeshme, brenda një dite mund të flasin një ose më shumë ministra. Ministri që paraqet fjalën në Kuvend duhet të merret vesh paraprakisht me kryetarin e Kuvendit për kohëzgjatjen e përafërt të fjalimit. Pasi ta ketë mbajtur fjalën, kryetari i Kuvendit lejon të parashtrihen komente ose pyetje në emër të grupeve parlamentare, si edhe nga deputetët e Kuvendit individualisht. Ministri që ka mbajtur fjalën ka të drejtë t'u përgjigjet shkurtimisht komenteve ose pyetjeve që mund t'i parashtrihen.

Rregulla 29: Çështjet urgjente

1. Në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente. Nëse kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t'i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozime në Kuvend që pastaj do ta vënë në votim. Nëse Kuvendi vendos ta marrë çështjen parasysh, atëherë duhet ta bëjë në atë takim, sepse orari dhe radhitja e kësaj pike rregullohen.
2. Propozimi i grupeve parlamentare për çështjet urgjente vendoset nga Kuvendi.

Rregulla 30: Mocionet procedurale

1. Në çdo seancë plenare të Kuvendit deputetit i jepet e drejta t'i propozojë këto mocione procedurale:
 - a) Mocionin për ta shtyrë debatin;
 - b) Mocionin për ta shtyrë seancën;
 - c) Mocionin për bartjen e një çështjeje në ndonjë komision;
 - d) Mocionin për përfundimin e debatit;
 - e) Mocionin për konstatimin a është shkelur Rregullorja e punës; ose
 - f) Mocionin për konstatimin nëse janë shkelur të drejtat e një deputeti.
2. Për mocionin për ta shtyrë debatin për një datë të caktuar në një debat të ardhshëm dhe për mocionin për ta shtyrë seancën, menjëherë mbahet votim pa debat.
3. Mocioni për kalimin e një çështjeje në ndonjë komision, duhet të specifikohet komisioni dhe arsyeja e kalimit. Nëse kryetari i Kuvendit vlerëson se mocioni është në rregull, çështja do të shqyrtohet menjëherë sipas rregullave që zbatohen në debate të tilla.
4. Mocioni për ta mbyllur debatin, mund të shqyrtohet vetëm nga shefat e grupeve parlamentare dhe votohet menjëherë në përputhje me rregullat.

5. Në rastet kur bëhet një mocion për të konstatuar se a është shkelur Rregullorja e punës, kryetari i Kuvendit do të vendosë që kjo të bëhet menjëherë ose kur është e nevojshme pas shqyrtimit të mëtejshëm të vendos nëse mocioni është i rregullt. Në rastet të tilla kryetari udhëzon shkelësin e Rregullores së punës ta respektojë atë.
6. Në rastet kur deputeti i Kuvendit ka bërë një mocion se të drejtat e tij si deputet i Kuvendit janë shkelur, kryetari i Kuvendit e shqyrton mocionin dhe brenda një (1) ditë pune ose më së voni në seancën e ardhshme të Kuvendit i raporton Kuvendit nëse janë shkelur të drejtat e deputetit. Nëse janë shkelur të drejtat e deputetit, kryetari i Kuvendit do ta urdhërojë shkelësin e rregullave të marrë masa për ta korrigjuar shkeljen.
7. Mocioni për ta shtyrë debatin, për ta shtyrë seancën, për ta kaluar një çështje në komision ose për ta mbyllur debatin duhet të ketë mbështetjen së paku të një grupi parlamentar para se të debatohen.
8. Mocionin për të konstatuar zbatimin e Rregullores së punës dhe mocionin për shkeljen e të drejtave të deputetit, mund t'i bëjë, madje, vetëm një deputet. Ky mocion i parashtrohet Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, që në seancën e parë plenare të Kuvendit duhet ta paraqesë rekomandimin e tij lidhur me mocionin.

Rregulla 31: Kuorumi dhe votimi

1. Shumica e deputetëve të Kuvendit përbën kuorumin.
2. Mbledhjet e Kuvendit ndërpriten nëse numri i deputetëve të pranishëm në sallë bie nën një të tretën e numrit të përgjithshëm. Nëse janë të pranishëm më pak se një e treta e deputetëve, atëherë bie zilja për një kohë (pesë minuta) dhe fillon numërimi. Nëse nga numërimi del që më pak se një e treta e numrit të përgjithshëm të deputetëve janë të pranishëm në sallë, atëherë kryetari i Kuvendit e ndërpret seancën për aq kohë sa ai e konsideron se mund të sigurohet së paku pjesëmarrja e numrit të domosdoshëm të deputetëve.
3. Vendimet që merren në mbledhjet e Kuvendit janë të vlefshme në qoftë se në kohën kur merren kanë qenë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit (kuorumi). Ligjet, vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit konsiderohen të miratuara kur për to të ketë votuar shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, me përjashtim të rasteve kur me Kornizë Kushtetuese dhe me këtë rregullore parashihet ndryshe.
4. Votimi bëhet sipas njëres nga mënyrat si vijon:
 - a) votimi i thjeshtë “për” apo “kundër” me ngritje dore;
 - b) votimi i fshehtë; ose
 - c) votimi i regjistruar, që përfshin:
 - i) votimin elektronik; ose
 - ii) thirrjen e secilit deputet veç e veç.

5. Votimi i regjistruar bëhet në rastet kur këtë e kërkon kryetari i Kuvendit ose një grup parlamentar, por për këtë vendos Kuvendi. Në raste kur mbahet votimi i regjistruar, vota e secilit deputet “për” ose “kundër”, ose “abstenim” do të regjistrohet me emër.
6. Në rast të numrit të barabartë të votave të dhëna “për” dhe “kundër” ndonjë propozimi, vlerësohet se ai propozim është hedhur poshtë.

Rregulla 32: Parashtrimi i mocioneve përmbajtjesore

1. Mocioni përmbajtjesor, që është amendament, duhet t’i dërgohet me shkrim, mundësisht edhe në formë elektronike, Zyrës për Propozime dhe Parashtrësja jo më pak se tetë (8) ditë pune para debatimit për rezolutën ose për projektligjin, të cilit i përket amendamenti, për të siguruar se amendamenti është hartuar ashtu siç ishte paraparë dhe se është përkthyer në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
2. Mocioni përmbajtjesor, që është rezolutë, dërgohet në Zyrën për Propozime dhe Parashtrësja jo më pak se tetë ditë pune para debatimit, përveç kur të jetë fjala për çështje urgjente. Zyra për Propozime dhe Parashtrësja është përgjegjëse për përkthimin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, për redaktimin dhe për shpërndarjen e këtij mocioni për të gjithë deputetët, më pak se pesë (5) ditë pune para debatit.
3. Kur një mocion i ngritur ka të bëjë me ndonjë dokument, dokumenti duhet t’i bashkëngjitet mocionit në kohën e caktuar në alinetë paraprake.

KREU X MIRATIMI I LIGJEVE

Rregulla 33: Propozimi i ligjeve në Kuvend

1. Projektligjin mund ta paraqesin për shqyrtim në Kuvend:
 - a) Qeveria;
 - b) Komisioni;
 - c) Një deputet i Kuvendit, i përkrahur nga pesë deputetë të tjerë që kanë nënshkruar Projektligjin;
 - d) Grupi parlamentar;
 - e) Në rastet kur Kuvendi me vendim udhëzon Qeverinë që ta hartojë një projektligj për shqyrtim në Kuvend në pajtim me rregullën 34;
2. Kur një projektligj paraqitet në Kuvend për shqyrtim, duhet të përmbajë edhe:
 - a) Materien e ligjit;
 - b) Objektivat që ky ligj dëshiron t’i realizojë;
 - c) Mënyrën si duhet të realizohen këta objektiva dhe
 - d) Efektin buxhetor në vitin e parë dhe në vitet e më pastajme që shoqëron ligjin;
 - e) Faktorët kryesorë për zbatimin e ligjit

3. Çdo projektligj duhet të:
 - a) Përkthehet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze nga personeli kompetent i Qeverisë ose i Kuvendit;
 - b) Dorëzohet në Zyrën për Propozime dhe Parashtrës të Kuvendit me shkrim dhe në formën elektronike.
4. Zyra për Propozime dhe Parashtrës menjëherë e evidencon dhe deputetëve ua shpërndan tekstin e projektligjit.

Rregulla 34: Udhëzimet për përgatitjen e një projektligji

1. Në rastet kur deputeti i Kuvendit ia paraqet Zyrës për Propozime dhe Parashtrës një mocion që Kuvendi ta udhëzojë Qeverinë ta përgatitë një projektligj, Kryesia kërkon mendimin e Qeverisë.
2. Në rastet kur Kryesia pajtohet të gjejë kohë për ta shqyrtuar propozimin, atëherë ai u dërgohet të gjithë deputetëve të Kuvendit, së bashku me komentet e Qeverisë.
3. Në rast se propozimi i një deputeti sipas paragrafit 1 të kësaj rregulle përkrahet të paktën nga pesë deputetë, Kryesia e fut atë në procedurë për debat, jo më pak se tri javë pune.
4. Në rastet kur Kuvendi miraton propozimin, Qeveria do ta përgatitë projektligjin , brenda tre (3) muajsh.

Rregulla 35: Shqyrtimi i parë i projektligjeve

1. Shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita pas shpërndarjes së tij.
2. Shqyrtimi i parë nënkupton miratimin në parim të projektligjit. Në shqyrtimin e parë nuk propozohen amendamente në projektligj.
3. Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit të parë deri para fillimit të procedurës së votimit për miratim në parim.
4. Pas miratimit të projektligjit në shqyrtimin e parë, projektligji u dërgohet Komisionit Përgjegjës Raportues dhe Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese dhe Komisionit për Buxhet. Komisioni Funkcional është komisioni përgjegjës raportues.
5. Në raste të veçanta projektligji mund t'u dërgohet disa komisioneve njëkohësisht. Në këtë rast njëri prej tyre caktohet komision përgjegjës raportues.
6. Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy (2) muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi. Komisioni përgjegjës raportues e shqyrton projektligjin për herë të parë por jo më vonë se dy javë pas miratimit në shqyrtimin e parë.
7. Komisioni funksional - përgjegjës raportues ose kryesor, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare.

8. Komisioni përgjegjës raportues me të përfunduar shqyrtimin ka për detyrë që Kuvendit t'ia paraqesë raportin së paku pesë (5) ditë pune para shqyrtimit të dytë.
9. Propozimet për amendamente me implikime buxhetore i dërgohen për deklarim Komisionit për Buxhet i cili duhet të deklarohet së paku 4 ditë pune para seancës plenare.
10. Buxheti vjetor i institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ) shqyrtohet në pajtim me këtë rregullore, me përjashtim të asaj që
 - a) Komision përgjegjës raportues do të jetë Komisioni për Buxhet;
 - b) Komisioni për Buxhet është komision i vetëm që mund t'i bëjë rekomandime Kuvendit në lidhje me buxhetin.
11. Kur kërkohet nga një anëtar i Kryesisë projektligji duhet t'i dorëzohet Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve për mendim në lidhje me të, në këtë rast projektligji i dorëzohet Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve për mendim në lidhje me të jo më shumë se 24 orë pas shqyrtimit të parë.

Rregulla 36. Shqyrtimi i projektligjeve nga komisionet

1. Komisionet gjatë shqyrtimit të projektligjeve u përmbahen dispozitave të përgjithshme për komisionet.
1. Shqyrtimi i një projektligji në komision nënkupton hartimin dhe dërgimin e raportit me rekomandime për Kuvendin:
 - a) për amendamentet që konsiderohen të nevojshme, dhe
 - b) varësisht nga këto amendamente, projektligji në fjalë mund të rekomandohet për miratim me rastin e shqyrtimit të dytë të tij.
2. Në rastet kur më shumë se një komision është i angazhuar në shqyrtimin e një projektligji, secili nga ato komisione duhet ta informojë komisionin drejtues për konkluzionet e nxjerra. Në veçanti duhet të tërhiqet vëmendja e Komisionit Buxhetor për çdo amendament të propozuar. Në rastet kur një komision, duke përfshirë edhe Komisionin për Buxhet, konsideron se projektligji ose propozimet e komisionit drejtues kanë implikime për fushën e tij të përgjegjësisë, ai komision e përmend këtë në rekomandimet e tij të komisionit përgjegjës raportues e për Kuvendin.
3. Komisionet që shqyrtojnë një projektligj duhet t'i raportojnë Kuvendit me shkrim, duke cekur në veçanti tekstet e çdo amendamenti në projektligjin që propozohet. Kryetari i Komisionit Përgjegjës Raportues, ose raportuesi duhet të lejohen t'i drejtohen Kuvendit për ta përforcuar raportin me shkrim.

Rregulla 37. Shqyrtimi i dytë i projektligjeve

1. Përveç amendamenteve të propozuara nga Komisioni Përgjegjës Raportues dhe deputetët, Kuvendi shqyrton edhe amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve si dhe amendamentet nga Qeveria dhe Grupet parlamentare. Propozuesit të amendamenteve i jepet e drejta që ta arsyetojë propozimin e vet me kërkesë të tij.

2. Amendamentet shqyrtohen veç e veç sipas radhës që paraqiten në tekstin e projektligjit, përveç nëse ndonjë grup i amendamenteve ka ndikim veprues në nenet e tjera. Në këtë rast ata mund të shqyrtohen aty ku paraqiten së pari në tekst dhe mund t'i nënshtrohen një votimi të vetëm. Kryetari i Kuvendit vendos kur gjen zbatim kjo. Komisioni Përgjegjës Raportues, gjithashtu, përcakton radhën sipas së cilës do të shqyrtohen amendamentet sipas natyrës përmbajtjesore të tyre kur paraqiten në të njëjtin vend në tekst.
3. Në rastet kur të gjitha amendamentet e zgjedhura për shqyrtim të jenë miratuar ose janë hedhur poshtë, teksti i projektligjit me ndryshimet e bëra do të shqyrtohet pasi të jetë caktuar koha për debat të mëtejme para votimit përfundimtar.
4. Mënyra dhe procedura e parashtrimit të amendamenteve përmbajtjesore nga entitetet e autorizuara përcaktohen me udhëzim të veçantë.

Rregulla 38. Shqyrtimi i tretë i projektligjeve

1. Kuvendi mund të vendosë për ta paraqitur një projektligj që nuk arrin të marrë numrin e duhur të votave në shqyrtimin e dytë, për një shqyrtim të tretë, së bashku me amendamentet e tjera të mundshme, që janë miratuar. Amendamentet që janë shqyrtuar dhe janë refuzuar në shqyrtimin e dytë, ose janë të ngjashme me këto amendamente, nuk do të propozohen përsëri.
2. Procedura e shqyrtimit të amendamenteve plotësuese dhe pastaj e projektligjit të ndryshuar, nëse janë miratuar amendamentet plotësuese, përsëri do të jetë në pajtim me rregullën 37, paragrafët 1-4.

Rregulla 39. Nënshkrimi i ligjeve të miratuara nga Kuvendi

Ligjet e miratuara nga Kuvendi, qoftë në shqyrtimin e dytë, qoftë në të tretin, nënshkruhen nga kryetari i Kuvendit, brenda 10 ditë pune, por jo para afatit të përcaktuar në Rregullën 40.1. Ato pastaj i dërgohen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP) për t'i shpallur. Ligjet hyjnë në fuqi ditën e shpalljes nga PSSP-ja, përveç rasteve kur në mënyrë specifike vetë ligji e parasheh ndryshe.

Rregulla 40. Kundërshtimi i ligjeve në bazë të ndikimit të tyre mbi interesat vitale të komuniteteve

1. Brenda dyzet e tetë orësh pas miratimit të ligjit nga Kuvendi sipas procedurave të rregullave 37, 38 çdo deputet i Kuvendit, i mbështetur nga pesë ose më tepër deputetë, mund t'ia paraqesë Kryesisë një mocion, me pretendimin se ligji në fjalë, ose dispozitat specifike të tij, shkelin interesat vitale të komunitetit të cilit ai/ajo i përket. Mocioni duhet të përmbajë një shpjegim të arsyeshëm për shkeljet e pretenduara. Mocioni mund të bazohet në çështjen se ligji, ose disa dispozita të caktuara të tij, janë diskriminuese ndaj një komuniteti, cenojnë të drejtat e tyre sipas kapitullit 3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme (të drejtat e njeriut), ose kapitullit 4 (të drejtat e komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre), ose në mënyra të tjera bien ndesh seriozisht me aftësinë e komunitetit për të ruajtur ose shprehur identitetin e tij etnik, kulturor, fetar ose gjuhësor.

2. Kryesia kërkon nga propozuesit e ligjit, ose të dispozitave që si përgjigje të sigurojnë argumente të arsyeshme brenda tri ditësh. Në të njëjtën kohë, Kryesia do të kërkojë nga propozuesit dhe nga kundërshtuesit që ta caktojnë nga një përfaqësues për t'i përfaqësuar nëse është e nevojshme në Panelin Special të parashikuar në paragrafin vijues. Megjithatë Kryesia do të bëjë përpjekje që në instancën e parë t'ia paraqesë Kuvendit një propozim konsensual brenda pesë ditësh pasi ta ketë marrë përgjigjen nga propozuesi.
3. Nëse Kryesia nuk arrin ta paraqesë propozimin konsensual brenda pesë ditësh, këtë çështje automatikisht e merr përsipër një panel special tre anëtarësh i përbërë nga përfaqësues të propozuesve dhe të kundërshtuesve dhe nga një anëtar që do ta kryesonte panelin, i caktuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të OKB-së. Paneli merr vendim brenda pesë ditësh dhe i rekomandon Kuvendit ose ta hedhë poshtë mocionin, ligjin ose dispozitën në fjalë, ose Kuvendi ta miratojë ligjin me ndryshimet e propozuara nga Paneli. Paneli merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të tij.
4. Kuvendi vendos a do ta pranojë propozimin konsensual të Kryesisë, poqë se një propozim i tillë është bërë, apo rekomandimet e Panelit. Në këtë fazë nuk do të prezantohen ndryshime të tjera, përpos atyre të bëra nga Kryesia (paragrafi 2 më sipër), ose nga Paneli (paragrafi 3 më sipër). Nëse Kuvendi i refuzon propozimin konsensual të Kryesisë ose rekomandimin e Panelit, ose nëse e pranon propozimin e Kryesisë apo rekomandimin e Panelit për refuzimin e mocionit, ligji mbetet ashtu siç ka qenë miratuar më parë nga Kuvendi.

KREU XI KOMISIONET E KUVENDIT

Rregulla 41. Funkzioni i komisioneve

1. Për numrin e komisioneve dhe për strukturën e tyre vendos Kuvendi, sipas propozimit të Kryesisë.
2. Komisionet kanë për detyrë të procedojnë pa vonesë çështjet që u dërgohen atyre. Komisionet kanë për detyrë t'i rekomandojnë Kuvendit vendimet përfundimtare që kanë të bëjnë vetëm me çështjet ose me punët që u janë dërguar atyre, apo për pyetjet që lidhen drejtpërsëdrejti me ta. Ato, megjithatë, mund të merren edhe me çështje të tjera që janë brenda fushëveprimit të tyre.
3. Përderisa rregullat që mbulojnë procedurat në komisione nuk përcaktojnë ndryshe, për komisionet zbatohen në mënyrë analoge dispozitat për seancën plenare.

Rregulla 42: Emërimi i kryetarëve dhe i nënkryetarëve të komisioneve

1. Ministri i Qeverisë nuk mund të jetë anëtar i një komisioni.
2. Asnjë deputet nuk mund të jetë kryetar në më shumë se një komision.
3. Kryesia do t'ia japë çdo grupi parlamentar, të përfaqësuar në Kuvend, të drejtën që t'i nominoj kryetarët ose nënkryetarët e komisioneve.

4. Grupet parlamentare nominojnë kryetarët për komisione të ndryshme në pajtim me marrëveshjen e arritur në Kryesi. Në marrëveshjen për shpërndarjen e posteve për kryetarë të komisioneve midis grupeve parlamentare, Kryesia merr parasysh proporcionin e forcës së grupeve parlamentare.
5. Për postin e kryetarit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, nominimi bëhet nga grupet parlamentare të një komuniteti, përveç komunitetit të shumicës.

Rregulla 43. Mbledhjet e Komisionit

1. Mbledhjet e Komisionit thirren nga kryetari i Komisionit ose nga njëri prej nënkryetarëve të autorizuar në pajtim me kalendarin e përpiluar nga Kryesia, përveç kur kryetari i komisionit vendos për mbajtjen e mbledhjes.
2. Kryetari, ose njëri prej nënkryetarëve të autorizuar, ka për detyrë ta caktojë mbledhjen për datën tjetër më të përshtatshme, nëse një e treta e anëtarëve të komisionit këtë e kërkon.
3. Datën dhe rendin e ditës i cakton kryetari ose njëri prej nënkryetarëve të autorizuar, përveç nëse komisioni ka marrë vendim më parë në lidhje me to. Rendi i ditës u komunikohet anëtarëve të Komisionit, jo më vonë se katër ditë pune para se të mbahet mbledhja. Rendi i ditës mund të ndryshojë me vendim të Komisionit
4. Komisioni, nëse është e nevojshme, mbledhet të paktën çdo dy javë pune.

Rregulla 44. Komisionet – dispozita të tjera

1. Mbledhjet e komisioneve të Kuvendit në parim janë të hapura, përveç në rastet kur një komision:
 - a) diskuton çështjet e sigurisë në Kosovë, që janë edhe në kompetencë të rezervuar të PSSP-së.
 - b) diskuton detajet e kontratave komerciale që përfshijnë IPVQ-në dhe një palë të tretë dhe diskutohet për çështje komerciale konfidenciale; ose
 - c) përgatit projekt-rekomandimet ose rekomandimet përfundimtare, duke përfshirë edhe hartimin e ndonjë raporti të rëndësishëm për Kuvendin.
 - d) si dhe në raste të tjera kur këtë e vlerëson komisioni.
2. Gjatë shqyrtimit të projektligjit, komisionet ftojnë propozuesin e projektligjit të marrë pjesë në mbledhjet e tyre.
3. Komisionet mund të angazhojnë këshilltarë-ekspertë në pajtim me udhëzimet procedurale dhe financiare të nxjerra nga Kryesia..
4. Komisionet mund të ftojnë persona të tjerë ose përfaqësues të institucioneve dhe të shoqërisë civile që të marrin pjesë në mbledhjet e komisionit.
5. Komisionet mund ta ftojnë secilin nga këta persona apo organe të paraqesin prova dhe ofrojnë dokumente.

6. Komisionet mund të mbajnë mbledhje të përbashkëta me komisionet e tjera. Një komision mund t'u ofrojë komisioneve të tjera informacione, ose dokumente nëse ato këtë e kërkojnë prej tyre.
7. Dispozitat për autoritetin e kryetarit të Kuvendit zbatohen sa më mirë për kryetarin e Komisionit. Kryetari i komisionit ka për detyrë ta caktojë mbledhjen në tjetër datë më të përshtatshme, nëse këtë e kërkojnë kryetari i Kuvendit, Kryesia, një grup parlamentar ose një e treta e anëtarëve të komisionit..
8. Në mbledhjet e komisioneve ftohet përfaqësuesi i Qeverisë që të marrë pjesë.
9. Komisionet vendosin ta thërrasin një anëtar të Qeverisë, ministrin ose zëvendësministrin. Anëtarët e Qeverisë kanë të drejtë të dëgjohen në mbledhjet e komisionit në çdo kohë.

Rregulla 45. Dëgjimet publike

1. Për të marrë informacione për një çështje në shqyrtim e sipër, komisioni mund të mbajë dëgjime publike të ekspertëve, të organizatave publike, të përfaqësuesve të grupeve të interesit dhe të personave të tjerë, që mund të ofrojnë informacion.
2. Komisioni mund të hyjë në diskutime të gjera me persona që ofrojnë informacion derisa të jetë e nevojshme për sqarimin e fakteve.
3. Në përgatitjen e dëgjimeve publike, komisioni i këshillon ata që ofrojnë informacion lidhur me pyetjet që do t'u drejtohen atyre.

Rregulla 46. Raportet

1. Si rregull raportet e komisionit për Kuvendin bëhen me shkrim. Raportet e Komisionit Përgjegjës Raportues mund të plotësohen me gojë nga kryetari i Komisionit Përgjegjës Raportues, nga një anëtar i caktuar ose raportuesi i tij.
2. Raportet duhet të përmbajnë rekomandime të komisionit së bashku me arsyetimin përkatës, si dhe mendimin e kundërt.

Rregulla 47. Komisioni Përgjegjës Raportues

1. Kuvendi cakton me vendim njërin nga komisionet funksionale si komision përgjegjës për të referuar për projektligj. Me këtë rast zbatohen në mënyrë analoge dispozitat e rregullës 41.
2. Detyra kryesore e Komisionit Përgjegjës Raportues është shqyrtimi i projektligjit ose i mocionit të dërguar, radhitja e amendamenteve, rekomandimi, si dhe konstatimi i amendamenteve që bien ndesh me njëri-tjetrin.
3. Në pajtim me detyrat e tij koordinuese mes Komisioneve, Komisioni përgjegjës raportues merr të paktën dy javë para shqyrtimit të dytë propozimet dhe raportet mbi punën e bërë nga komisionet e tjera dhe deputetët.

4. Raportimi në Kuvend për projektligj bëhet vetëm nga Komisioni Përgjegjës Raportues .
5. Raporti përmban propozimet e Komisionit Përgjegjës Raportues, për të cilat Kuvendi do të marrë vendim në mbledhjen plenare, si dhe pjesën e dytë, arsyet dhe opinionet e kundërta dhe komentet e komisioneve përkatëse.
6. Raportuesi ose kryetari i Komisioni Përgjegjës Raportues paraqet punën dhe rezultatet e komisionit në Kuvend

Rregulla 48. Komisionet kryesore dhe komisionet funksionale

1. Dy komisionet kryesore të Kuvendit janë: Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Dispozitat e veçanta për Komisionin e Buxhetit janë paraparë në rregullën 51, ndërsa dispozitat e veçanta të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve janë paraparë në rregullën 52.
2. Kuvendi themelon:
 - i. Një komision *ad hoc* për Rregulloren e punës në pajtim me paragrafin 4 të rregullës 3;
 - ii. Komisione të tjera funksionale të përhershme, si vijon::
 1. Komisioni për Buxhet dhe Financa
 2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthimin
 3. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, Barazi Gjinore, Peticione dhe Kërkesa Publike
 4. Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim Euro-Atlantik
 5. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport
 6. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
 7. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor
 8. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe për Persona të Zhdukur,
 9. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media,
 10. Komisioni për Gatishmëri Emergjente.
 11. Komisioni për Mandate dhe Imunitete.
3. Fushëveprimi dhe përgjegjësitë e secilit komision përcaktohen me një akt të veçantë të Kuvendit.
4. Kuvendi përcakton numrin e komisioneve funksionale dhe numrin e anëtarëve për çdo komision funksional, në bazë të propozimit të Kryesisë. Deputeti i Kuvendit në parim mund të jetë vetëm në një komision.
5. Anëtarësia e të gjitha komisioneve funksionale duhet t'i reflektojë diversitetin dhe sjelljet e anëtarëve të Kuvendit.
Nëse një grup parlamentar i përfaqësuar në Kuvend nuk ka asnjë anëtar në një komision të caktuar funksional, ka të drejtë t'i dërgojë deputetët e vet në cilësinë e vëzhguesit në të gjitha mbledhjet e atij komisioni.
6. Grupet parlamentare emërojnë anëtarët e komisioneve dhe zëvendësit e tyre.

7. Kryetari emëron deputetët pa grupe të Kuvendit si anëtarë të komisioneve, që marrin pjesë aktivisht në mbledhjet e komisioneve funksionale pa të drejtë vote.
8. Përveç kryetarit, të gjitha komisionet- qofshin ato kryesore ose funksionale- duhet t'i kenë nga dy nënkryetarë, që u përkasin grupeve të ndryshme parlamentare nga ai i kryetarit, ku të paktën njëri prej tyre është i komuniteti tjetër nga ai i kryetarit.
9. Postet për kryetar dhe nënkryetarë të komisioneve do t'i ndajë Kryesia midis grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, sipas mënyrës së paraparë në rregullën 42 të kësaj rregulloreje.
10. Më pas Kuvendi emëron anëtarët e komisioneve, në bazë të propozimit të Kryesisë, përveç në rastin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, për të cilin është paraparë një dispozitë e veçantë në rregullën 52. Kryesia duhet të sigurojë për sa është e mundur që përfaqësimi në komisione, duke përfshirë edhe deputetët e emëruar si kryetarë ose nënkryetarë, të jetë në përpjesëtim me përfaqësimin e tyre në Kuvend. .

Rregulla 49. Nën komisionet

1. Për të ndihmuar punën e vet, çdo komision mund të krijojë -me anëtarët e tij -nën komisione për detyra specifike. Krijimi i nën komisioneve, së bashku me listën e anëtarëve të tij, duhet t'i komunikohet Kryesisë.
2. Krijimi i nën komisionit kërkon mbështetjen e dy të tretave të anëtarëve të komisionit.
3. Dy ose më shumë komisione kanë të drejtë të kërkojnë krijimin e nën komisioneve të përbashkëta për çështje të interesit të përbashkët. Krijimi i nën komisioneve të përbashkëta duhet të mbështetet nga Kryesia.
4. Grupet parlamentare nominojnë anëtarë të nën komisioneve. Ata mund të nominojnë një anëtar tjetër, që nuk është anëtar i komisionit që ka krijuar nën komisionin, vetëm në raste të veçanta dhe për këtë njoftohet Kryesia e Kuvendit.
5. Në krijimin e nën komisioneve mbahet parasysh raporti i forcës së grupeve parlamentare. Me kërkesë të tij, çdo grup parlamentar në komision duhet të përfaqësohet të paktën me një anëtar në nën komision.
6. Nën komisioni kryen aktivitetet që janë në kompetencë të komisionit dhe brenda fushës së detyrave për të cilat është krijuar, në bazë të autorizimeve të komisionit.
7. Nën komisioni për punën e vet i raporton komisionit.

Rregulla 50: Komisioni hetues parlamentar dhe komisionet e tjera

2. Kuvendi mund ta formojë një komision *ad hoc* me tërë autoritetin e komisionit funksional, për të bërë hetime për një çështje të veçantë. Nëse Kuvendi merr vendim për themelimin e komisionit *ad hoc*, në vendim duhet të përfshihet:
 - a) Përbërja e anëtarëve të komisionit *ad hoc* duhet të jetë në pajtim me rregullën 42; dhe

- b) Kur Kuvendi identifikon një çështje të veçantë, ai autorizon Komisionin që ta ftojë secilin zyrtar të Kosovës të dëshmojë para komisionit. Kuvendi i përcakton procedurën, kohëzgjatjen e mandatit të funksionimit të këtij komisioni si dhe shpenzimet e mundshme të punës së tij
3. Kur Kuvendi e sheh të arsyeshme, mund të formojë edhe komisione të tjera *ad hoc* për kryerjen e punëve brenda autorizimeve të tij.

Rregulla 51: Komisioni për Buxhet dhe Financa

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, gjithashtu, ka 12 anëtarë. Përfaqësimi i grupeve parlamentare në këtë komision, duke përfshirë këtu kryetarin dhe nënkryetarët, duhet të reflektojë, për aq sa është e mundur, përfaqësimin e të gjithë anëtarëve në Kuvend.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa i shqyrton:
 - a) Çështjet buxhetore dhe ato financiare;
 - b) Buxhetin vjetor të IPVQ-së në pajtim me rregullën 35, paragrafi 10; dhe
 - c) Implikimet buxhetore për vitin e parë dhe për vitet në vazhdim që shoqërojnë projektligjin dhe të bëjë rekomandime në komisionin përkatës funksional ose në Kuvend.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa gjithashtu ka përgjegjësi për kontrollin e raporteve vjetore dhe të pasqyrave të reviduara financiare të buxhetit të konsoliduar të Kosovës, që lidhen me buxhetin e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes dhe me raporte të tjera të revizionit financiar që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit, të kryetarit, të Qeverisë, të ministrive, ose me aktivitete të tjera të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes, të mbështetura drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga buxheti i konsoliduar i Kosovës. Komisioni për Buxhet dhe Financa i dorëzon Kuvendit kohë pas kohe raporte në lidhje me këto rezultate, kurse Kuvendi duhet të gjejë mundësi për t'i shqyrtuar këto raporte.

Rregulla 52: Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve

1. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve përbëhet prej dy anëtarëve nga secili komunitet i Kosovës që është zgjedhur në Kuvend, nga komunitetet e përfaqësuara në Kuvend me vetëm një anëtar, por që në komision janë të përfaqësuar nga ai anëtar.
2. Anëtarësia, siç është specifikuar në paragrafin 1, është e përbërë nga kryetari, që nominohet nga një grup parlamentar që përfaqëson një komunitet përveç komunitetit të shumicës dhe dy nënkryetarë, të zgjedhur sipas mënyrës së paraparë në paragrafin 3 të rregullës 42.
3. Gjatë shqyrtimit të ligjeve të propozuara Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, mund të vendosë të deklarohet lidhur me ligjin e propozuar, me qëllim që të sigurojë adresimin e duhur të të drejtave dhe të interesave të komuniteteve. Një deklaram i tillë mund t'i drejtohet komisionit përkatës funksional të Kuvendit, ose Kuvendit, sipas nevojës, kurse dhe duhet të dorëzohet brenda dy javësh pas shqyrtimit të parë në Kuvend.

4. Kryesia e Kuvendit (komisioni kryesor ose ai funksional i Kuvendit), ose një grup i përbërë nga dhjetë ose më shumë deputetë të Kuvendit mund t'i drejtohet Komisionit për ta marrë mendimin konsultativ për një çështje.
5. Kur një anëtar i Kryesisë ka dorëzuar kërkesë për të marrë një opinion nga Komisioni në pajtim me paragrafin 11 të rregullës 35, komisioni mund të vendosë të bëjë rekomandime për projektligjin, nëse shumica e anëtarëve të komisionit pajtohet dhe çdo rekomandim i tillë duhet të dorëzohet jo më vonë se dy javë pas shqyrtimit të parë.

Rregulla 53: Autoriteti i komisioneve për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve

1. Çdo komision brenda fushës së tij të përgjegjësive ka autoritet për të mbikëqyrur zbatimin e ligjit nga Qeveria e Kosovës ose nga ministria përkatëse.
2. Ministria përkatëse i raporton komisionit funksional në lidhje me zbatimin e ligjit pa kërkesë, së paku një herë në vit.
3. Për ta ushtruar autoritetin e dhënë më lart, komisionet:
 - a. Bëjnë kontrole dhe studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi për çështje të fushëveprimit të tyre, si zbatohen ato dhe propozojnë masa për raste konkrete;
 - b. Përgatisin një listë që përmban ndër të tjera:
 - i. datën e shpalljes së ligjit
 - ii. datën e publikimit të tij në “Gazetën zyrtare”
 - iii. listën e dispozitave të ligjit që duhet të zbatohen nga Qeveria
 - iv. listën e vendimeve të Qeverisë se këto dispozita i zbatojnë.
 - c. Ushtrojnë kontroll të veprimtarisë së përgjithshme të ministrisë përkatëse; dhe
 - d. Raportojnë me shkrim dhe me gojë një herë në vit në mbledhjet plenare të Kuvendit.
4. Nëse ministria nuk raporton ose nëse raportimi i saj konsiderohet i paplotë, me kërkesë të komisionit, çështja vihet në rendin e ditës së seancës tjetër plenare.

KREU XII PËRDORIMI I GJUHËVE NË KUVEND

Rregulla 54: Përdorimi i gjuhëve në Kuvend

Mbledhjet e Kuvendit dhe të komisioneve mbahen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, duke siguruar përkthimin sipas nevojës. Deputetët e Kuvendit që nuk i përkasin komunitetit shqiptar as atij serb lejohet t'u drejtohen Kuvendit dhe komisioneve të tij në gjuhën e tyre. Në rastet e tilla për deputetët e tjerë të Kuvendit, apo të komisioneve, sigurohet përkthimi në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe sipas nevojës.

Rregulla 55: Gjuha e dokumenteve

1. Të gjitha dokumentet zyrtare të Kuvendit shkruhen në gjuhën standarde shqipe dhe në gjuhën serbe. Kuvendi do të përpiqet që dokumentet zyrtare t'i përgatitë në gjuhën e atij komuniteti, përveç atij shqiptar dhe serb, të cilit i referohet dokumenti. Deputetët e Kuvendit nga këto komunitete mund t'i dorëzojnë Kuvendit ose komisioneve të tij, dokumente në gjuhën e tyre, për shqyrtim. Në raste të tilla përkthimi në gjuhën shqipe dhe në atë serbe për deputetët e tjerë të Kuvendit ose të komisioneve, do të sigurohet sipas kërkesës.
2. Transkripti i punimeve të Kuvendit regjistron çdo diskutim vetëm në gjuhën e folësit.

KREU XIII ADMINISTRATA E KUVENDIT

Rregulla 56. Administrata e Kuvendit

1. Administrata e Kuvendit është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes profesionale, administrative dhe teknike për nevoja të Kuvendit, të Kryesisë, të komisioneve, të grupeve parlamentare dhe të deputetëve të Kuvendit.
2. Organizimi i punës së shërbimeve të administratës së Kuvendit rregullohet me akt të veçantë, që e miraton Kryesia me propozim të sekretarit të Kuvendit.
3. Sekretari është udhëheqës i administratës së Kuvendit në vartësi të Kryesisë.

KREU XIV RAPORTI ME PSSP-në

Rregulla 57. Raporti me PSSP-në

PSSP-së i dërgohen të gjitha agjendat dhe dokumentet që u shpërndahen deputetëve të Kuvendit, në të njëjtën kohë kur u shpërndahen deputetëve. Ai ose përfaqësuesi i tij i caktuar ka të drejtë të marrë pjesë në seancat plenare të Kuvendit dhe t'i drejtohet Kuvendit sipas marrëveshjes paraprake.

KREU XV NDRYSHIMI I RREGULLORES SË PUNËS TË KUVENDIT

Rregulla 58. Ndryshimi i Rregullores së punës

1. Kryesia e shqyrton vazhdimisht Rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime, që mendon se janë të nevojshme.
2. Kryesisë së Kuvendit mund t'i bëhet propozimi për ndryshimin e Rregullores nga çdo deputet i mbështetur të paktën nga dhjetë (10) deputetë të tjerë.
3. Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës, e merr Kuvendi, me shumicë votash të anëtarëve të Kuvendit.
4. Derisa të nxirret një rregullore e re, Kuvendi vepron sipas rregullores së vjetër.

Rregulla 59. Procedurat për ndryshimin të Kornizës Kushtetuese

Me mbështetjen e dy të tretave të deputetëve të Kuvendit dhe në pajtim me Kornizën Kushtetuese (Kreu 14.3), Kuvendi i Kosovës fillon procedurën për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese.

KREU XVI SHPËRNDARJA E KUVENDIT

Rregulla 60. Shpërndarja e Kuvendit

1. Çdo propozim për Kuvendin, me të cilin kërkohet nga PSSP-ja të shpërndahet Kuvendi sipas kushteve të paragrafit 8.1 (b) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, duhet t'i drejtohet kryetarit të Kuvendit, që bënë përgatitjet e duhura për diskutim në Kuvend brenda pesë (5) ditëve të punës.
2. Pa paragjykuar kompetencat e PSSP-së, të paktën dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit, mund të kërkojnë nga PSSP-ja të shpërndajë Kuvendin. Një kërkesë të tillë PSSP-së ia komunikon kryetari i Kosovës.

KREU XVII INTERPRETIMI I RREGULLAVE TE PROCEDURES

Rregulla 61. Shmangiet nga Rregullorja e punës

Për shmangiet nga Rregullorja e punës mund të vendos Kuvendi me dy të tretat e shumicës së deputetëve të pranishëm në Kuvend, përveç nëse kjo është në kundërshtim me dispozitat e Kornizës Kushtetuese.

Rregulla 62. Interpretimi i Rregullores së punës

Nëse ka dyshime gjatë një mbledhjeje të Kuvendit në lidhje me interpretimin e Rregullores së punës, kryetari, ose anëtari i Kryesisë që kryeson mbledhjen, merr vendim për çështjen në fjalë. Kryetari, ose anëtari i Kryesisë që kryeson mbledhjen, mund të vendosin që t'ia referojnë çështjen Kryesisë.

KREU XVIII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Rregulla 63. Punët e pambaruara

Në fund të mandatit të Kuvendit të gjitha punët që i janë besuar atij do të konsiderohen të përfunduara. Kjo nuk gjen zbatim në rastin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi e të proceduara për shpallje, si dhe të peticioneve dhe të atyre punëve, që nuk kërkojnë të merret një vendim nga Kuvendi.

Rregulla 64. Hyrja në fuqi

Rregullorja e punës hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi. Në këtë datë pushojnë së ekzistuari dispozitat e Rregullores së përkohshme Rregullorja e punës do të botohet në "Gazetën zyrtare".

Rregulla 65. Shtojcat e Rregullores së punës

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë shtojcat e mëposhtme:

1. Kodi i mirësjelljes së deputetëve të Kuvendit.
2. Të drejtat shtesë të deputetëve, derisa të nxirret akti i veçantë.

Nr. 02/53
20 maj 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci

SHTOJCË NR. 1.

KODI I MIRËSJELLJES SË DEPUTETËVE TË KUVENDIT

Parime të përgjithshme

1. Deputetët janë të obliguar t'i përmbahen ligjit dhe në të gjitha rastet të veprojnë në pajtim me besimin e popullit që u është dhënë, duke u kujdesur në veçanti për parimet vijuese:
 - (a) Vetëmohimi. Deputetët marrin vendime që janë vetëm me interes publik. Ata nuk mund të marrin vendime për përfitime financiare apo përfitime të tjera materiale për vete, për familjet e tyre apo për shokët.
 - (b) Integriteti moral. Deputetët nuk duhet të kenë detyrime financiare ndaj individëve apo organizatave që mund të ndikojnë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare.
 - (c) Objektiviteti. Deputetët duhet të vendosin vetëm në bazë të meritave dhe të interesit publik gjatë përmbushjes së funksioneve publike, duke përfshirë edhe emërimet publike, shpalljen e fituesit të kontratave ose rekomandimin e individëve për shpërblime dhe subvencione.
 - (ç) Përgjegjësia. Deputetët mbajnë përgjegjësi për vendimet e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen një vetëkontrolli të kujdesshëm që i përgjegjet funksionit të tyre.
 - (d) Sinqeriteti. Deputetët duhet të jenë sa më të sqertë që të jetë e mundur për të gjitha vendimet dhe aksionet që i ndërmarrin. Ata duhet të japin arsyet për vendimet e tyre dhe të kufizojnë dhënien e informacioneve, përveç nëse këtë e kërkon qartazi interesi i gjerë publik.
 - (dh) Ndershmëria. Deputetët janë të obliguar të deklarojnë për çfarëdo interesi privat që mund të jetë relevant për detyrat e tyre publike dhe duhet të ndërmarrin hapa për zgjidhjen e konflikteve eventuale për të mbrojtur interesin publik.
 - (e) Aftësia udhëheqëse. Deputetët me udhëheqje dhe shembuj konkret duhet të sigurojnë mbështetjen e këtyre parimeve.

Deklarata gojore e dobive para pjesëmarrjes në mbledhje të Kuvendit apo të komisioneve

2. Kur deputeti i Kuvendit ose anëtari i familjes së ngushtë ka interes personal financiar në ndonjë çështje që shqyrtohet nga Kuvendi ose nga ndonjë komision, në të cilin ai është anëtar, ai duhet ta deklarojë gojarisht atë përfitim para se të marrë pjesë në mbledhje ku diskutohet çështja në fjalë.
3. Kjo vlen edhe për situatat kur deputeti pret që të ketë interes personal financiar në një çështje, edhe pse ai mund të mos ketë interes në kohën e mbajtjes së mbledhjes.

Kufizimet në votim

4. Edhe nëse jepet deklaratë në pajtim me paragrafët paraprak 2 dhe 3, deputeti nuk ka të drejtë të votojë për një çështje për të cilën vendimi mund të rezultojë me përfitim financiar për të dhe i njëjti as që do të pranohej nga një kategori e gjerë e njerëzve që nuk janë deputetë të Kuvendit ose nga të afërmit e deputetëve të Kuvendit.

Ndalimi i propagimit të paguar në Kuvend

5. Deputeti i Kuvendit nuk mund të propagojë ose të inicojë çfarëdo rrjedhe ose çështjeje në mbledhjet e Kuvendit apo të komisioneve të tij, si shkëmbim për pagim ose përfitim tjetër në nature, qoftë direkte apo indirekte. E njëjta gjë vlen, nëse pagesa ose përfitimi është pranuar nga anëtari i familjes së ngushtë të deputetit.

Regjistrimi i interesave të deputetëve

6. Pa paragjykuar kërkesën e paraparë në paragrafin 2 dhe 3, për të bërë deklaratë gojore për çfarëdo interesi personal relevant financiar para pjesëmarrjes në diskutime për një çështje në Kuvend apo në komisionet e tij, deputetët duhet gjithashtu ta informojnë Kryetarin e Kuvendit me shkrim për të gjitha të mirat financiare që posedojnë ata apo familja e tyre e ngushtë dhe për fitimet financiare që ata mund t'i marrin nga kategoritë vijuese:
 - (a) Punësimi, tregtia, profesioni ose mjeshtria (përveç anëtarësimit në Kuvend) për të cilin deputeti paguhet ose ka interes financiar;
 - (b) Drejtimi i ndërmarrjeve publike dhe private për të cilin fitohet shpërblim (edhe nëse është paguar përmes një ndërmarrjeje të varur);
 - (c) Kontratat për konsultime, përfaqësime ose shërbime të ngjashme jashtë detyrave për të cilat janë deklaruar;
 - (ç) Kontratat për gazetari, shkrime të tjera, mbajtje të ligjëratave etj.;
 - (d) Dhuratat, jashtë vlerës së përcaktuar nga Kryetari i Kuvendit, që lidhen me privilegjet e tyre si deputet të Kuvendit, duke përfshirë edhe ato nga mikpritja dhe udhëtimi;
 - (dh) Sponzorizimi financiar për kandidim për zgjedhje të Kuvendit, përveç mbështetjes nga partia politike, koalicioni apo iniciativa e qytetarëve që deputeti përfaqëson, e që tejkalon 25 % të shpenzimeve për zgjedhjen e kandidatit;
 - (e) Mbështetje financiare si deputet i Kuvendit, përveç mbështetjes nga partia politike, koalicioni ose iniciativa e qytetarëve që deputeti përfaqëson.
7. Deklarata e shkruar duhet t'i dorëzohet Zyrës së Kryetarit të Kuvendit, brenda 30 ditësh nga seanca inauguruese e Kuvendit dhe duhet të përtrihet brenda 30 ditësh nga paraqitja e ndryshimeve materiale.

SHTOJCA NR. 2

TË DREJTAT SHITESË TË DEPUTETIT

Rregulla 1:Të drejtat shitesë të deputetit

1.1 Në momentin e verifikimit të mandatit të deputetit, deputeti fiton të gjitha të drejtat që duhet t'i gezojë si deputet, pra edhe të drejta shitesë, më qëllim të sigurimit të kushteve për ushtrimin me sukses të funksionit që ka.

Këto të drejta përfshijnë:

- a) Të drejtën e kompensimit material në të ardhura mujore.
- b) Të drejtën në kompensime shitesë të të ardhurave
- c) Të drejtën e mbulimit të shpenzimeve të qëndrimit dhe të udhëtimit të deputetit brenda dhe jashtë vendit me detyrë zyrtare.
- d) Të drejtën e shfrytëzimit të shërbimeve të Kuvendit.
- e) Të drejtën e informimit
- f) Të drejtën e disponimit të dokumentacionit identifikues të deputetit.

Rregulla 2: E drejta e kompensimit material në të ardhura mujore

- 2.1 Deputetit që nga momenti i verifikimit të mandatit i takojnë të ardhura mujore, lartësinë e të cilave e cakton Kryesia e Kuvendit, në bazë të propozimit të Komisionit për Buxhet.
- 2.2 Deputetit, pas përfundimit të rregullt të mandatit, i takojnë të ardhurat mujore për periudhën prej dymbëdhjetë (12) muajsh të përcaktuara më Rregullën 2.1, po qe se ai gjatë kësaj kohë nuk kthehet në vendin e punës të cilin e ka pasur para zgjedhjes si deputet, ose në vend tjetër të përshtatshëm për të.
- 2.3 Përrjashtimisht nga kjo dispozitë, deputetit të cilit i ka pushuar mandati mbi bazat e përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit , Rregulla 10 pikat 1-5 ,si dhe ne bazë të dorëheqjes së tij, nuk i takojnë të ardhurat mujore.
- 2.4 Me rastin e pushimit të mandatit të deputetit për shkak të vdekjes, familjes së deputetit me rastin e varrimit të tij i takon shuma në të holla në lartësinë e të ardhurave mujore për dy muaj, si edhe e të ardhurave mujore në lartësinë e përcaktuar ne Rregullën 2.1 në gjatësi kohore të një viti kalendarik nga dita e pushimit të mandatit.

Rregulla 3: Kompensimet shtesë të të ardhurave

- 3.1 Përveç të të ardhurave mujore të përcaktuara me Rregullën 2.1, çdo deputeti i takojnë edhe të ardhura shtesë për pjesëmarrje në seancat e Kuvendit, për punën në komisionet e Kuvendit dhe për punën në trupa të tjerë jashtë veprimtarisë së rregullt të tij.
- 3.2 Me vendim të posaçëm të Kryesisë së Kuvendit, për pjesëmarrje në seancat e Kuvendit deputetit i jepet të ardhura shtesë për çdo seancë.
- 3.3 Për mospjesëmarrje të paarsyeshme në ndonjërin nga seancat e Kuvendit, deputetit nuk i jepet kompensimi shtesë i parashikuar me Rregullën 3.2 për atë seancë.
- 3.4 Deputetit i jepet kompensim shtesë për pjesëmarrje në punën e komisioneve.
- 3.5 Të ardhurat nga pika 3.4 të kësaj rregulle, deputetit do t'i takojnë proporcionalisht me pjesëmarrjen e tij në punën e komisionit gjatë muajit.
- 3.6 Kryetarët e komisioneve kryesore dhe funksionale marrin një shtesë të veçantë, e cila caktohet me vendim të veçantë të Kryesisë.
- 3.7 Kryetarët e grupeve parlamentare marrin një shtesë të veçantë, e cila caktohet me vendim të veçantë të Kryesisë së Kuvendit.
- 3.8 Anëtarët e komisionit do të paguhet për punën e komisioneve, për secilin komision veç e veç.
- 3.9 Vendimin mbis lartësinë e të ardhurave mujore dhe të kompensimeve shtesë e merr Kryesia e Kuvendit në bazë të propozimit të Komisionit për Buxhet.

Rregulla 4: Të ardhurat e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit

- 4.1 Anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit ,përveç të ardhurave të rregullta mujore si deputet, u takojnë edhe të ardhura shtesë për punën në Kryesinë e Kuvendit.
- 4.2 Për pjesëmarrje të rregullt në mbledhje të Kryesisë dhe në seancat plenare, anëtarëve të Kryesisë u jepet kompensim shtesë.
- 4.3 Anëtarëve të Kryesisë të cilët mungojnë pa arsye nga mbledhjet e Kryesisë dhe nga seancat plenare, u heqen të ardhurat e theksuara me Rregullën 4.2.
- 4.4 Vendimin për lartësinë e të ardhurave shtesë të anëtarëve të Kryesisë e merr Kryesia, në bazë të propozimit të Komisionit për Buxhet.

Rregulla 5: Kompensimi i punës së deputetit për punën jashtë veprimtarisë së rregullt në Kuvend

- 5.1 Deputetit i cili angazhohet për kryerjen e punëve të Kuvendit, jashtë veprimtarisë së rregullt dhe të detyrimeve që i ka si deputet, i takon kompensim material. Kompensimi caktohet me vendim të veçantë të Kryesise dhe duhet të jetë adekuat me vlerën e punës së bërë.

Rregulla 6: E drejta e mbulimit të shpenzimeve të qëndrimit dhe të udhëtimit të deputetit brenda dhe jashtë vendit

- 6.1 Deputetit, i cili udhëton zyrtarisht jashtë ose brenda vendit - jashtë vendbanimit të tij, qoftë individualisht ose në përbërje të delegacionit që e përfaqëson Kuvendin apo trupat e tij, i takon kompensimi i shpenzimeve të qëndrimit, i atyre të udhëtimit, si dhe medijtja.
- 6.2 Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, të qëndrimit dhe lartësia e medijtjeve përcaktohet sipas standardeve që vlejnë për IPVQ –të e Kosovës, në bazë të vendimit të veçantë të Kryesisë së Kuvendit

Rregulla 7: E drejta e shfrytëzimit të shërbimeve të Kuvendit

- 7.1 Te gjithë deputetët e Kuvendit kanë të drejtë të shfrytëzojnë të gjitha shërbimet e Kuvendit, duke përfshirë: ndërtesën e Kuvendit, shërbimet profesionale të Kuvendit, shërbimet kompjuteristike, internetin dhe shërbimet e tjera elektronike, shërbimin e bibliotekës, shërbimin e përkthyesve, shërbimet e transportit dhe shërbimet e tjera.
- 7.2 Shërbimet e theksuara në pikën 7.1 të kësaj rregulle mund të shfrytëzohen përmes Sekretarisë së Kuvendit, duke e lajmëruar atë për kërkesat veç e veç.

Rregulla 8: E drejta e informimit

- 8.1 Çdo deputet i Kuvendit ka të drejtë të jetë i informuar për punën në Kuvend dhe të shpreh opinionet e veta lidhur me çështjet e caktuara. Këto opinione mund t'i shprehen udhëheqjes së Kuvendit në mënyrë të drejtëpërdrejtë , përmes pyetjeve të parashtruara, apo nëpërmjet debatit në Kuvend

Rregulla 9: E drejta e disponimit me dokumentacion identifikimi

- 9.1 Sekretaria e Kuvendit është e obliguar që çdo deputeti t'i sigurojë dokumentin identifikues.
- 9.2 Dokumenti përmban shënimet elementare për deputetin, Kuvendin e Kosovës si dhe në tekst të shkurtër të drejtën e hyrjes dhe të lëvizjes së papenguar të tij në institucionet e Kosovës, në institucionet e tjera publike, si dhe në gjithë territorin e Kosovës.
- 9.3 Deputetit i sigurohet edhe një librezë e veçantë e imunitetit.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të kreut 9.1.26 (f) të Kornizës Kushtetuese dhe të rregullës 4.4 të Rregullores së punës së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për hartimin e Rregullores së punës të Kuvendit, në Seancën plenare të mbajtur më 20 maj 2005, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës.
2. Autorizohet Komisioni për Rregullore që të bënë standardizimin gjuhësor dhe juridik të Rregullores së Punës dhe të njëjtën ta boton si broshurë, për të gjithë deputetët.

Nr. 02-456/05

Në Prishtinë, më 20 maj 2005

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik Nexhat Daci

U dërgohet:

- Deputetëve të Kuvendit,
- Stafit të Administratës dhe
- Arkivit.

